

PROCESVERBAL

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “SERENO AL”

Sot, me datë 25/10/2025 mbahet ky procesverbal, në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” midis anëtarëve të Shoqërisë; Erind Mulaj, shtetas shqiptar, i biri Xhevdetit, lindur më 08/10/1997, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J71008057L, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I cili:

V E N D O S I:

Krijimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “SERENO AL”

- Miratimin e statutit dhe të programit të saj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi suprem i shoqërisë. Ajo përbëhet nga ortaku i vetëm dhe merr çdo vendim në mënyrën më të mirëpraktikueshme. Asambleja funksionon sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i Shoqërisë do të jetë Erind Mulaj, i cili do të zgjidhet për një afat pesëvjeçar.

THEMELUESI

Erind Mulaj

Erind Mulaj


AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SERENO AL” SHPK

Sot, me date 25/10/2025:

Erind Mulaj, shtetas shqiptar, i biri Xhevdetit, lindur më 08/10/1997, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J71008057L, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I cili kerkoi perpilimin e këtij akti themelimi të shoqerisë tregtare **“SERENO AL” Sh.P.K.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqeria Tregtare **“SERENO AL” SH.P.K.**, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“SERENO AL” SH.P.K.**.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **“SERENO AL” Sh.p.k.** do të jetë:

- A) Hapjen dhe administrimin e bareve, restoranteve, pizzerive, fast food, lounge, pub dhe çdo njësi tjetër të ngjashme të shërbimit ushqimor;
- B) Përgatitjen dhe tregtimin e ushqimeve të gatuar, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, embëlsirave dhe produkteve të tjera të ngjashme;
- C) Shitjen dhe shpërndarjen online të produkteve ushqimore dhe pijeve, përmes platformave elektronike, faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare;
- D) Organizimin e eventeve të ndryshme sociale dhe biznesi (bankete, festa, konferenca)
- E) Veprimtari të tjera ndihmëse ose plotësuese të lidhura me fushën e hotelierit turizmit, ushqimit dhe shërbimit ndaj klientit, që lejohet nga legjislacioni në fuqi.



Shoqëria mund të ushtrojë edhe çdo aktivitet tjetër të ligjshëm, të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, pasi të jenë kryer procedurat përkatëse ligjore, nëse kërkohet.

NENI 4 **Selia e Shoqerise**

Selia e Shoqerise ndodhet ne Qytetin e Tiranës, ne adresen: Rruga Hiqmet Buzi, Sauk, Godina nr. 2, Njësi shërbimi 05, Tiranë.

NENI 5 **Kapitali i Shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete i perbere nga kontributi i ortakut te vetem themelues te kesaj Shoqerie ne para ne vleren 10000 (dhjetemije) leke, dhe eshte teresisht ne te holla nga ortakut i vetem i shoqerise perkatesisht: Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise jane si me poshte:

1. **Z. Erind Mulaj**, ne cilesine e ortakut te vetem themelues zoteron 1 kuote me 100% te vleres ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar eshte investuar nga ortakut themelues ne total.

NENI 6 **Kohezgjatja e shoqerise**

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mund te zgjatet ose shkurtohet, dy ose disa here, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve.

NENI 7 **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare", organet drejtuese te shoqerise jane si me poshte vijon:

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve – organi me i larte vendimarrës;
2. Administratori/et – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerise.

Menyra e organizimit te tyre dhe funksionimit eshte e percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

Shoqeria do te administrohet nga Administratori/et i/te cilet zgjidhen per afat pese vjeçar.

Administrator i Shoqerise do te jete Z. Erind Mulaj, shtetas shqiptar, i biri i Xhevdetit, lindur me 08/09/1997, mbajtes i leternjoftimit me numër personal J7100857L, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar. Shoqeria perfaqesohet para çdo organi administrativ, gjyqesor, enti publik apo privat dhe ne marredhenie me te tretet nga administratori, i cili i ushtron keto te drejta ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.



NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saj, do te behet ne perputhje me dispozitat e ligjit perkates dhe statutit.

NENI 9

Ortaku/et e shoqerise detyrohen te ruajne sekretin e themelimit dhe te veprimtarise se Shoqerise. Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e Shoqerise mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhdemtojne Shoqerine per demet qe i jane shkaktuar per faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshem

Veprimtaria e shoqerise rregullohet nga rregullat e Statutit te firmosur nga ortaku themelues sipas parashikimeve te ligjit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve te Shoqerise, ne rastet qe do kete mbi nje ortak, te cilet mund te kene si objekt te drejta si rrjedhim i raporteve te tyre me shoqerine do te zgjidhen me ndermjetesim dhe Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem, Tirane.

NENI 12

Dispozitat perfundimtare

Akt Themelimi hartohet ne kater kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi u lexua nga Ortaku i vetem Themelues, i cili e gjen ate ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe e nenshkruan ate pa verejtje.

Ky akt themelimi u redaktua ne gjuhen shqipe te njohur dhe pranuar nga pala.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Erind Mulaj

Erind Mulaj
[Signature]

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SERENO AL” SHPK

Sot, me date 25/10/2025:

Erind Mulaj, shtetas shqiptar, i biri Xhevdetit, lindur më 08/10/1997, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J71008057L, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Ka vendosur themelimin e shoqerise tregtare “**SERENO AL**” Sh.P.K., me termat e mëposhtme:

Shoqeria Tregtare “**SERENO AL**” SH.P.K., është formuar si shoqeri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, (ne vazhdim Shoqeria).

Shoqeria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 1

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise “**SERENO AL**” Sh.p.k. do te jete:

- A) Hapjen dhe administrimin e bareve, restoranteve, pizzerive, fast food, lounge, pub dhe çdo njësi tjetër të ngjashme të shërbimit ushqimor;
- B) Përgatitjen dhe tregtimin e ushqimeve të gatuar, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, embëlsirave dhe produkteve të tjera të ngjashme;
- C) Shitjen dhe shpërndarjen online të produkteve ushqimore dhe pijeve, përmes platformave elektronike, faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare;
- D) Organizimin e eventeve të ndryshme sociale dhe biznesi (bankete, festa, konferenca)
- E) Veprimtari të tjera ndihmëse ose plotësuese të lidhura me fushën e hotelierisë turistike, ushqimit dhe shërbimit ndaj klientit, që lejohet nga legjislacioni në fuqi.



NENI 2.

Emri dhe selia e Shoqerise

Shoqeria eshte Person Juridik Privat. Shoqeria do te paraqitet ne qarkullim me emertimin e saj **“SERENO AL” SH.P.K.**

Selia e Shoqerise ndodhet ne Qytetin e Tiranes, ne adresen Hiqmet Buzi, Sauk, godina nr. 2, njesi sherbimi 05, Tirane,

NENI 3.

Kohezgjatja e Shoqerise.

Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit eshte i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaket e Shoqerise mund te vendosin kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj dy apo disa here, sipas dy vendimi te posaçem.

NENI 4.

Regjimi Juridik i Shoqerise.

Shoqeria udhehiqet nga parimet e ekonomise se tregut dhe ka per qellim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit se Themelimit, Statutit si dhe dispozitave te legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mundet qe te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore qe do te jene ne fuqi si dhe ne perputhje te plote me dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj, duke bere edhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar. Shoqeria do te kete vulen e saj.

NENI 5

Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete i perbere nga kontributi i ortakut themelues te kesaj Shoqerie ne para ne vleren 10000 (dhjetemije) leke, dhe eshte teresisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise perkatesisht:

1. **Z. Erind Mulaj**, ne cilesine e ortakut te vetem themelues zoteron 1 kuote me 100% te vleres ne kapitalin themeltar.



Kapitali themeltar eshte investuar nga ortakut themelues ne total.

II. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE.

NENI 6

Ortakut nuk mbajne pergjegjesi per humbjet e shoqerise pervec per pjesen e pashlyer te kontributeve te tyre qe duhet te derdhen ne kapitalin fillestar.

Pasurite e krijuara nga Shoqeria gjate aktivitetit te saj jane ne pronesi te Ortakeve. Ato (pasurite) mund te tjetersohen, te jepen me qera, te lihen peng e hipoteke me miratimin e Ortakeve.

NENI 7.

Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve.

Ortakut japin kontributin e tyre ne shoqeri ne para apo ne natyre, sipas menyrave dhe afateve te percaktuara ne statut. Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne te gjitha ortakut per ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare dhe, me kerkesen e tyre, duhet t'u vene ne dispozicion llogarite vjetore, perfshire llogarite e konsoliduara, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe cdo dokument tjeter te brendshem te shoqerise, me perjashtim te rastit te sekretit tregtar, i cili eshte dy e dhene e vleresuar nga shoqeria si informacion i brendshem apo dokument qe shoqeria mbron, i cili ne rast se do tu perhapej personave te paautorizuar do ti shkaktonte dem te konsiderueshem interesave tregtare te shoqerise.

Ortakut kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe te shesin pjesen e tyre te kapitalit, ne perputhje me kushtet e percaktuara ne Statut dhe ne ligj.

Heqja dore nga shoqeria nuk i liron ata nga detyrimet qe ata kane ndaj shoqerise deri ne momentin e heqjes dore dhe nuk rrezikon marrjen e te ardhurave nga shoqeria te siguruar deri ne ate moment.

III. KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE.

NENI 7.

Veprimtaria e funksionimit te Shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise se tregut. Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimet e llogarise dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.



NENI 8.

Pronesia mbi kuotat.

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nepermjet:

- kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- shit-blerjes;
- trashegimise;
- dhurimit;
- ne çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

NENI 9.

Miratimi i Asamblese se Pergjithshme per fitimin apo kalimin e kuotave.

Pavaresisht nga menyra e fitimit apo kalimit te kuotave, eshte i nevojshem miratimi i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne çdo rast, ortaket e shoqerise gezojne te drejten e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen sipas ligjit, ndryshe jane te pavlefshme.

NENI 10.

Kuotat mund te anulohen ne çdo rast me miratimin e ortakut perkates dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i rrjedhin ortakut nga zoterimi i kuotes, shuhen me anulimin e tyre.

Rastet e anulimit te kuotes do te percaktohen nga rregullore te posaçme, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve me 51% te votave. Ndersa likuidimi i saj do te behet sipas percaktimeve te nenit 10 te ketij statuti.

NENI 11.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet nga Asambleja e Pergjithshme e ortakeve.

NENI 12.

Fondet Rezerve



Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera financimi, per te perballur nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare per shlyerjen e detyrimeve gjate veprimtarise se saj.

NENI 13

Bilanci, plani financiar.

Pasuria e Shoqerise vleresohet ne bilancet e saj ne monedhe te vendit ose ne monedhe te huaj sipas vleresimit te Ortakeve ose eksperteve ne momentin e Themelimit te Shoqerise.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes. Forma e bilancit percaktohet nga Administratori ne harmoni me format e bilanceve te vendosura ne Republiken e Shqiperise.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik te Shoqerise, te shprehur ne leke ose valute te konvertueshme. Llogaria ekonomike do te mbahet ne Shqiperi. Shkembimi i monedhes shqiptare me ate te huaj dhe anasjelltas behet sipas kursit zyrtar ose privat te kembimit.

NENI 14.

Shperndarja e fitimeve

Ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise. Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

IV. ORGANET E SHOQERISE.

Asambleja eshte Organi suprem i shoqerise.

Asambleja funksionon sipas percaktimeve te bera ne kete statut dhe dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 15

Vendimet e Asamblese, ne perputhje me ligjin dhe normat e ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithë. Ato regjistrohen ne librin e shoqerise.

NENI 16

Çdo i interesuar mund te kerkoje ne Gjykate anullimin e vendimit te Asamblese se shoqerise te marre ne kundërshtim me ligjin apo normat e ketij statuti.



NENI 17

Aktiviteti financiar i shoqerisee kontrollohet nga Ekspertet kontabel te emeruar nga Asambleja e ortakeve.

ASAMBLEJA E SHOQERISE VENDIMARJA

NENI 18

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendim-marres i shoqerise. Ajo mblidhet ne seance te zakonshme te pakten çdo nje vit.

NENI 19

Mbledhja e zakonshme e Asamblese drejtohet nga adminstratori.

NENI 20

Ne mbledhjen e asamblese mund te marin pjese /Administratori kur ky eshte i jashtem, pra nuk eshte ortak ne shoqeri/, ekspertet kontabel te autorizuar, pa te drejte vote.

NENI 21

Mbledhja e Asamblese njoftohet me shkrim jo me pak se 15 dite perpara, ku duhet te permbaje, kohen/daten/oren/vendin dhe rendin e dites. Keto shenohen ne libri i shoqerise.

NENI 22

Asambleja vendos per:

- ndryshimin e dispozitave te statutit;
- emerimin e administratorit dhe shkarkimin e tij;
- miratimin e rregullores se brendeshme te shoqerise ose ndryshimin e dispozitave te saj;
- prishjen e parakohshme te shoqerise;
- ndryshim kapitalit themeltar;
- vendimet qe percaktojne politiken e drejtimit te shoqerise;
- emerim apo shkarkim te administratoreve te filjaleve te shoqerise;



- miratim ose mospranimin e propozimeve te administratorit per kushtet e kontrates se punes per personelin e shoqerise;
- miratimin e raportit vjetor te administrimit te shoqerise;
- miratimin e marreveshjeve apo investimeve;
- miratimin e struktures se shoqerise dhe ndryshimet e saj.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 23

Per drejtimin e shoqerise ortaket emerojne Administratorin, i cili mund te jete edhe person tjeter i zgjedhur nga themeluesi. Kur eshte i jashtem percaktohen dhe kushtet e punes nepermjet kontrates se punes.

NENI 24

Shoqeria "SERENO AL" sh.p.k. ka vulen e saj.

NENI 25

Emri i shoqerise, administratorit si dhe vula e shoqerise duhet te figurojne ne te gjitha shkresat zyrtare te shoqerise si dhe ne dokumentat qe kane te bejne me permbushjen e objektit, apo qe i sherbejne ushtrimit te aktivitetit te saj.

NENI 26

Administratori perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet, duke zbatuar politiken e drejtimit te shoqerise. Ne raste te vecanta mund dhe te caktoje nje njeri tjeter me prokure te posaqme.

NENI 27

Administratori mban pergjegjesi per shkelje te ligjit, statutit, rregullores se brendshme, para asamblese, te treteve dhe instancave ligjore.

NENI 28

Ne fund te cdo viti administratori pergatit Raportin vjetor te administrimit dhe ja paraqit Asamblese se bashku dhe me invetaret e llogarite vjetore.

NENI 29

Administrator eshte: **Z. Erind Mulaj** per nje periudhe pese vjecare.



Administratori ka keto kompetenca:

- perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet;
- drejton aktivitetin e shoqerise mbi baze te objektit te saj;
- punesimin e personelit te shoqerise;
- percaktimin e saksioneve e kushteve te kontratave te punes per personelin;
- thirrjen e mbledhjes se zakonshme;
- hartimin e paraqitjen e raportit vjetor.

NENI 30

Shoqeria nuk mer persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet apo veprime juridike te administratorit, kur keto nuk jane permbajtur objektit te veprimtarise se shoqerise, ose nuk jane ne qellim te permbushjes se objektit.

BILANCI DHE FITIMET

NENI 31

Viti financiar i shoqerise mbyllet me date 31.12. te cdo viti. Administratori ben inventarin dhe llogarite vjetore sipas dispozitave te kontabilitetit dhe harton nje raport me shkrim per administrimin Bilancit i bashkohet;

- nje situacion per garancite e dhena nga shoqeria;
- nje situacion per sigurimet e bera nga shoqeria.

NENI 32

Bilanci vjetor duhet te paraqitet ne organet tatimore, pasi miratohet nga Asambleja, brenda dates 31.03. te vitit pasardhes.

NENI 33

Ne rast te likuidimit te shoqerise, caktohet likuidatori, duke qene i detyruar te njoftoje per punet e shoqerise.

NENI 34

MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet dispozitave te Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise dhe legjislacionit ne fuqi.



Te gjithë personat e punësuar në shoqëri kanë të drejtë të përcaktojnë marrëdhëniet e punës nëpërmjet Kontrates së Punës dhe Kontrates Kolektive të Punës.

NENI 35

Mosmarrëveshjet e punës zgjidhen me ndërmjetësim dhe nga Gjykata e Rrethit, kur mjetet e tjera nuk japin rezultat. Shoqëria respekton rregullat e punësimit dhe të Sigurimeve Shoqërore, ndërsa të punësuarit janë të detyruar që t'i pranojnë e zbatojnë ato. Te gjithë të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës.

NENI 36

Asambleja e shoqërise përcakton, përfaqësimin e shoqërise në marrëdhënie me të tretet, organet gjyqësore, caktim të avokatit si dhe në marrëdhënie me sistemin fiskal e organet e tjera shtetërore.

NENI 37

Gjithë veprimtaria e shoqërise në aspektin ekonomik drejtohet nga Administratori i shoqërise. Pjesëmarrje me shoqëri të tjera, ndryshim statuti, kapitali themelor, miratim bilanci, pranimi ortake të rinj përcaktohet nga Asambleja e shoqërise.

MBARIMI I SHOQËRISË

NENI 38

Veprimtaria e shoqërise mbaron me vendim të Asamblesë së shoqërise, në rastet e parashikuara në ligj.

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

NENI 39

Likuidimi i shoqërise do të bëhet sipas dispozitave të Legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në çastin e likuidimit. Kur shoqëria kalon në procedurën e likuidimit Asambleja cakton komisionin e likuidimit, të cilit i paraqet pasqyrat e bilancit të likuidimit dhe shoqëria mbyll aktivitetin e saj në momentin kur ky bilanc aprovohet. Pasuria e shoqërise, pasi shlyhen detyrimet e shoqërise, i kalojnë themeluesit të shoqërise, sipas kapitalit themeltar.

NENI 40



Likuidimi i shoqerise vendoset me vendim te Asamblese se shoqerise i cili per te kryer veprimet qe kerkohen, emerohet nje likuidator me tagrat e percaktuara ne ligjin 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare" Likuidatori eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj te treteve. Ai shperblehet ne baze te vendimit te Asamblese te shoqerise.

NENI 41

Likuidatori i emeruar perfaqson shoqerine dhe nenshkruan duke vene firmen nen vulen e shoqerise. Ai duhet te perfundoje shitjet qe jane te disponueshme per llogari te shoqerise, te mare nga cdo debitor llogari te sakta ne monedhe dhe te ketheje pasurine e shoqerise ne para. Per ceshtjet e mbetura pezull vendos Asambleja e shoqerise per zgjidhjen e tyre. Ne perfundim te likuidimit te shoqerise likuidatori perpilon bilancin perfundimtar dhe te nxjerre buletin perkates.

VII. DISPOZITA TE FUNDIT.

NENI 42.

Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

NENI 43.


Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 44.

Ky Statut perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet pa verejtje nga ortaku i vetem themelues.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Erind Mulaj



SHOQERIA "SERENO AL" SH.P.K.
Tirane, me 25/10/2025